

VENDIM
Nr.311, datë 21.4.2011

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË NJË PJESE TË PASURISË SË
PALUAJTSHME, PRONË SHETËTËRORE, MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE DHE
TRANSPORTIT, PËR PROJEKTIN “NDËRTIM RRUGA UNAZA E RE E TIRANËS
(SEGMENTI KOMUNA E PARISIT-RRUGA E RE, TIRANË-ELBASAN)”**

Në mbështetje të neneve 42 e 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të neneve 13, 15 e 16 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, të ligjit nr.10 119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011” të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi dhe transferimin e mjedisit e të sipërfaqes 9 264 (nëntë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e katër) m² pronë në administrim të institucioneve shtetërore, pjesë e pasurive shtetërore, me emërtimin “Kopshti Botanik”, Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve, për projektin “Ndërtim rruga Unaza e Re e Tiranës (segmenti Komuna e Parisit-rruga e re, Tiranë-Elbasan)”, pjesë e Unazës së Madhe të Tiranës, sipas planimetrisë që jepet në aneksin nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të marrë masat për fillimin e ekzekutimit të punimeve të zbatimit të projektit “Ndërtim rruga Unaza e Re e Tiranës (segmenti Komuna e Parisit-rruga e re, Tiranë-Elbasan)”, në sipërfaqen e caktuar sipas pikës 1 të këtij vendimi, pasi të ketë përfunduar rrethimi i ri i Kopshtit Botanik.

3. Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të njoftojnë drejtuesit administrativë të Kopshtit Botanik për marrjen e masave administrative për zhvendosje eventuale të vlerave të florës që preken nga transferimi i pasurisë sipas pikës 1 të këtij vendimi, nëse ka të tilla, dhe të bazës materiale përpara fillimit të procedurës sipas pikave 1 dhe 2 të këtij vendimi.

4. Të gjitha shpenzimet për lirimin e sheshit sipas planimetrisë 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, pronë shtetërore, dhe përfundimin e punimeve të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2011, miratuar për Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve.

5. Kopshtit Botanik, për mbulimin e shpenzimeve operative për transferim të vlerave bimore sipas pikës 2 të këtij vendimi, t’i jepet nga buxheti i Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, në buxhetin e institucionit të miratuar për vitin 2011, zëri “Shpenzime korente”, shuma 200 000 (dyqind mijë) lekë.

6. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha